



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
BIBLIOTEKA KOMBËTARE

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më _____. 2018

KONTRATË

Nr. _____

E lidhur sot më datë ____/____/2018, mes *Agjencisë Kombëtare të Standardizimit të Botimeve të Librit*, me seli në Tiranë, me adresë Sheshi “Skënderbe”, Tiranë, Tel./Fax: + 355042269954, adresa elektronike isbn@bksh.al, përfaqësuar nga Personi i autorizuar nga Titullari i institucionit, më poshtë referuar si *Dhënës*

dhe

Botuesit / Entit Botues “ _____ ”, me seli në _____, regjistruar pranë QKR-së me nr. NIPTI _____ /Nr. Licence _____ /Vendim të Gjykatës së Rrethit _____ nr. _____, datë _____. dhe nr. NIPTI _____ përfaqësuar nga _____

, me adresë _____.

Tel./Fax _____ ; Adresa elektronike (e-mail) _____

_____ ; _____
më poshtë referuar si *Marrës*

**Kreu I
DISPOZITA TË PËRGJITSHME**

**Neni 1
Objekti**

Kjo kontratë nënshkruhet për shërbimin e dhënies/marrjen së Numrit Ndërkombëtar të Standardizimit të Librit (ISBN).

**Neni 2
Statusi juridik/Baza ligjore**

Hartimi i Kontratës mbështetet në Nenin 28 të Ligjit nr. 9616, datë 27.09.2006 “Për Librin në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, “Rregulloren e Funkcionimit të Agjencisë Kombëtare të Standardizimit të Botimeve të Librit”, si dhe Urdhrin e Ministrit të Kulturës, nr. 70, datë 13.2.2015, “Për miratimin e Statutit të Bibliotekës Kombëtare”.

Kreu II PARIMET DHE DETYRAT

Neni 3 Parimet/Dokumentacioni

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 7 të Rregullores së Funksionimit të Agjencisë Kombëtare të të Standardizimit të Botimeve të Librit, plotësohet dokumentacioni si më poshtë:

1. Për botuesit/shtëpitë botuese të regjistruara pranë Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) dokumente vërtetues janë:

a) Ekstrakti i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit (Person fizik, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar) lëshuar nga QKR/Licensa (QKL).

2. Për organizatat, shoqatat, institutet, qendrat, fondacionet, organizatat jofitimprurëse etj. që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre edhe veprimtari botuese, dokumente vërtetues janë:

a) Vendimi i Gjykatës për regjistrimin e subjektit në regjistrin e organizatave jofitimprurëse;
b) Nipti.

3. Për institucionet shtetërore (ministri, qendra, universitete, akademi, institute, banka etj.) dokumente vërtetues janë:

a) Dokumenti i aktit të krijimit/statuti/rregullorja;
b) Nipti.

Neni 4 Detyrat/detyrimet e Dhënësit

1. T'i bëjë të njohur **Marrësit** rregullat e dhënies dhe marrjes së ISBN-së duke i ofruar atij edhe një kopje të manualit përdorues të ISBN-së;

2. Të caktojë për çdo **Marrës** (botues) identifikuesin e botimeve në çdo fillimviti dhe t'ia njoftojë atë marrësit;

3. T'i japë **Marrësit** ISBN-në, brenda një afati maksimalisht 24-orësh, llogaritur në ditë të punëshme, pas kërkesës së tij;

4. T'i japë **Marrësit** numër të pandryshueshëm të identifikuar për çdo titull, lidhje, ribotim etj., që t'i përgjigjet sistemit të kontrollit ndërkombëtar nga Agjencia Ndërkombëtare e ISBN-së, i cili të përmbajë: identifikuesin e grupit, identifikuesin e botimit, identifikuesin e titullit, shifrën e kontrollit.

Neni 5 Detyrat/detyrimet e *Marrësit*

1. Të caktojë personin përgjegjës për marrjen, zbatimin dhe shënimin e ISBN-së në botimet e tij, i cili do të jetë
2. Të dërgojë pranë *Dhënësit* çdo ndryshim të adresës (numrit të telefonit/fax-it, adresës elektronike etj.) dhe çdo ndryshim të personit përgjegjës për botim;
3. Të dërgojë çdo fillimviti pranë *Dhënësit* numrin e titujve që parashikon të botojë;
4. Të paraqesë te *Dhënësi* kërkesën për marrjen e numrit të ISBN-së për çdo botim të ri (titull, lidhje, ribotim), sipas formularit-tip të ofruar nga kjo Agjenci, miratuar në Rregulloren e funksionimit të Agjencisë;
5. Të shënojë ISBN-në e marrë duke e shtypur në libër (të shoqëruar me barkod) sipas Nenit 27 të Ligjit nr.9616, datë 27.09.2006 “*Për Librin në Republikën e Shqipërisë*” të ndryshuar;
6. Të njoftojë *Dhënësin* për çdo numër të shtypur gabim;
7. Të njoftojë *Dhënësin* për çdo botim që nuk realizohet;
8. Të shlyejë ndaj Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë detyrimin që rrjedh nga Neni 42 i Ligjit nr. 9616, datë 27.09.2006 “*Për Librin në Republikën e Shqipërisë*” të ndryshuar;
9. Të bëjë dorëzimin e kopjeve të detyruara sipas **formularit tip** në zbatim të nenit 47 të Ligjit nr. 9616, dt. 27.09.2006 “*Për Librin në Republikën e Shqipërisë*” të ndryshuar, miratuar nga titullari i Bibliotekës Kombëtare.

Kreu III DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 6 Ankimimi

Marrësi ka të drejtën e ankimeve sipas procedurave të parashikuara në nenin 30 të Ligjit nr. 9616, datë 27.09.2006 “*Për Librin në Republikën e Shqipërisë*” të ndryshuar.

Neni 7 Pezullimi

Dhënësi ka të drejtën e pezullimit të dhënies së ISBN-së, në rastin e shkeljes së një ose më shumë nyjeve të kësaj Kontrate, si dhe të mospërsëritjes së Kontratës vjetore në rast të mosshlyerjeve të detyrimeve parashikuar në këtë Kontratë nga ana e *Marrësit*; pas shlyerjes së këyre detyrimeve, kontraktualiteti mes *Dhënësit* dhe *Marrësit* vijon pa rrjedhoja.

**Neni 8
Ndryshimet**

Çdo shtesë apo ndryshim miratohet nga Ministri i Kulturës, me propozim të drejtorit të Bibliotekës Kombëtare.

**Neni 9
Hyrja në fuqi**

Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj.

Për Agjencinë Kombëtare të ISBN-së

Për Botuesin / Entin Botues

**Vula e Agjencisë së ISBN-së
Botues**

Vula e Botuesit / Entit